



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

## RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
<b>Blerina Huruglica</b>	<b>09.10.2023</b>	<b>25.10.2023</b>	<b>2023/0752</b>

### BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 02.10.2023, OE “N.T.P.GRESA - COMMERCE&MBB Construction SHPK, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0752, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “N.T.P.Burimi, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me dru dhe pelet per ngrohje” me nr. të prokurimit: "624-23-6986-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA SUHAREKË.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratsë: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **970,200.00€**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

### DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së  
Neni 6 i LPP-së  
Neni 7 i LPP-së  
Neni 59 i LPP-së  
Neni 60 i LPP-së  
Neni 69 i LPP-së  
Neni 72 i LPP-së  
Neni 54.10 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik.

Sa i përket këtij aktiviteti të prokurimit, njoftimi për kontratë është publikuar me dt.08.07.2023, ndërsa hapja e ofertave për këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt.22.08.2023.

Me dt.13.09.2023 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është rekomanduar për kontratë OE N.P.T. Burimi, ndërsa ne jemi eliminuar nga aktiviteti i prokurimit me arsyetimin si në vijim:

*"Në lidhje me realizimin e kontratave AK ka kërkuar dëshmi në vlerë 1,400,000.00, ndërsa ju si OE keni ofruar referenca për kontratat e realizuara në vlerë prej 827,753.37 euro. Referencat si në vijim nuk mund të pranohen nga AK ngase kontratat për të cilat keni ofruar referenca janë në realizim e sipër pra nuk janë të përfunduara.*

*Referenca-Shkolla fillore e Mesme e Ulët "8 Dëshmorët" në Kralan*

*Referenca-Furnizim me pelet për ngrohje të objekteve shkollore-Komuna Klinë*

*Referenca-Furnizim me pelet për ngrohje qendrore për fakultetin e biznesit MTHM-së-kontratë kornizë-Universiteti Haxhi Zeka*

*Referenca-Furnizim me pelet për ngrohje qendrore në UHZ-Kontratë kornizë-Universiteti Haxhi Zeka".*

Ju sqarojmë se arsyet e lartcekura për eliminimin tonë janë të paqëndrueshme për faktet si në vijim:

Ne kemi prezantuar referenca për kontratat të cilat janë përfunduar **100%**, e disa të tjera **128%** dhe **130%**, mirëpo autoriteti kontraktues nuk i ka marr parasysh fare duke u arsyetuar se kinse nuk janë të përfunduara këto kontrata.

- 1. Në lidhje me referencën-Shkolla fillore e Mesme e Ulët "8 Dëshmorët" në Kralan**, ju sqarojmë se e njëjta referencë është dashur të merret parasysh për faktin se kontrata për të cilën është lëshuar kjo referencë është e përfunduar 100% dhe njëkohësisht është shfrytëzuar edhe devijimi i lejuar prej 30%, pra kontrata është përfunduar në tërësi. Autoriteti kontraktues është bazuar vetëm tek kohëzgjatja e kontratës (afati), mirëpo në këtë rast kjo kontratë është kontratë kornizë dhe e njëjta përfundon në momentin që përfundohet furnizimi. Përderisa është bërë furnizimi i lartcekur 100% dhe njëkohësisht është shfrytëzuar edhe 30% i devijimit të lejuar, atëherë kjo kontratë është e përfunduar, mirëpo që AK-ja nuk e ka marr parasysh fare këtë fakt.

Andaj referenca e lartcekur është dashur të merret parasysh nga ana e autoritetit kontraktues, pasi që furnizimi është kryer 130%, pra është përmbushur kontrata.

Tek Rregullorja nr.001/2022 për Prokurimin Publik, përkatësisht tek neni 54.10 është përcaktuar qartë " 54.10 Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Kurdo që Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse AK nuk deklaron përqindjen e mospërputhjes në dosje të tenderit, atëherë kontrata përfundon me vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan të vendosur. Nëse AK deklaron përqindjen e mospërputhjes në dosje të tenderit dhe nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%)), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht. Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes se pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull".

2. **Sa i përket referencës tjetër të cilën AK-ja nuk e ka marr parasysh- Furnizim me pelet për ngrohje të objekteve shkollore-Komuna Klinë**, ju sqarojmë se edhe në këtë rast kontrata për të cilën është lëshuar kjo referencë është e përfunduar 128%, pra përveç se është kryer furnizimi i 100% të kontratës, AK-ja KK Klinë ka shfrytëzuar edhe 28% e devijimit të lejuar.

Përveç këtij fakti, AK-KK Klinë ka publikuar aktivitetin e prokurimit të njëjtë sikurse aktiviteti për të cilin ne i kemi bërë furnizimet dhe njëkohësisht ka nënshkruar edhe kontratën për të njëjtin aktivitet, pra është nënshkruar një kontratë e re.

Me kërkesë për rishqyrtim e kemi bashkangjitur edhe sqarimin e KK Klinë, ku të njëjtit e konfirmojnë faktin se e kanë kaluar kontratën me 128% dhe se të njëjtit kanë lidhur një kontratë të re.

Andaj nga kjo dëshmi kuptohet se edhe kjo kontratë ka përfunduar për faktin se tanimë KK Klinë ka lidhur një kontratë të re me një OE tjetër dhe kjo kontratë është e përfunduar, andaj edhe referenca është dashur të merret parasysh. **(Bashkangjitur gjeni sqarimin dhe konfirmimin nga KK Klinë dhe kontratën e nënshkruar).**

3. **Në lidhje me referencat nga Universiteti Haxhi Zeka**, të cilat referenca autoriteti kontraktues nuk i ka marr parasysh, ju sqarojmë se edhe këto kontrata janë përfunduar 100%. Vlen të ceket fakti se edhe Universiteti Haxhi Zeka ka publikuar njoftimin për kontratë me titull "FURNIZIM ME PELET PËR NGROHJEN QENDRORE NE UHZ-ë-KONTRATË KORNIZË", ku përveç njoftimit për kontratë e njëjta ka publikuar edhe njoftimin mbi vendimin me dt.01.09.2023, ku ne jemi rekomanduar për kontratë dhe tani jemi në pritje të

nënshkrimit të kontratës. **(Bashkangjitur gjeni njoftimin mbi vendimin dhe njoftimin për kontratë).**

Duhet cekur fakti se tek kontratat kornizë ku parashihen sasitë e përafërta dhe +-30%, kontrata mund të përfundohet me realizimin e furnizimeve prej 70% deri në 130%, varësisht prej kërkesave dhe nevojave të AK-së. 30% është taveni i përcaktuar për realizimin e mundshëm të furnizimeve, ndërsa nuk është obligative që të realizohet 130% kontrata, por mund të realizohet edhe 100, 105, 110 etj.

4. Me kërkesë për rishqyrtim i kemi bashkangjitur edhe transaksionet bankare në lidhje me kontratën me kompani private e cila është përfunduar në tërësi, ashtu siç vërtetohet edhe nga transaksionet të cilat po ju bashkangjesim.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se ne jemi eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit, pa ndonjë bazë ligjore dhe njëkohësisht jemi diskriminuar si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë.

Me dt.21.09.2023 kemi pranuar vendimin për aprovim të pjesërishtëm të kërkesës për rishqyrtim, mirëpo që lënda nuk është kthyer në rishqyrtim por AK-ja ka qëndruar mbrapa njoftimit mbi vendimin (B58).

Në këtë vendim janë aprovuar pretendimet tona ankimore 1 dhe 2, kurse çuditërisht janë refuzuar pretendimet tona ankimore 3 dhe 4, ndërsa janë shtuar edhe disa arsye tjera për eliminimin tonë të cilat nuk kanë qenë të vendosura tek njoftimi mbi vendimin e AK-së.

Sa i përket përgjigjes së AK-së në lidhje me pretendimin tonë ankimore nr.3, ku AK-ja e ka cekur i njëjti nuk qëndron me arsyetimin se asnjë dispozitë ligjore nuk e ndalon iniciimin e aktivitetit pa u përfunduar kontrata, me rëndësi është që nënshkrimi i kontratës së re të mos ndodh para datës së përfundimit të kontratës aktuale, ju sqarojmë se ky arsyetim i të njëjtës nuk qëndron.

Fillimisht në lidhje me referencat e lëshuara nga Universiteti Haxhi Zeka, autoriteti kontraktues nuk e ka marr parasysh asnjërin nga dy referencat edhe pse kontrata e nënshkruar në vitin 2021 është përmbushur në tërësi dhe ne si kompani kemi nënshkruar kontratë të re tani në vitin 2023. Pra kjo kontratë është përfunduar në tërësi mirëpo çuditërisht AK-ja është munduar të gjej arsytetime të cilat nuk përkojnë fare me gjendjen reale.

Për referencën tjetër të lëshuar nga Universiteti Haxhi Zeka ku AK-ja e ka cekur se aktiviteti i prokurimit mund të iniciohet pa u përfunduar kontrata, ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar dhe njëkohësisht është vetëm tendencë e të njëjtës që neve të na shpall si tenderues të papërgjegjshëm me arsye krejtësisht të pa bazuara. Ne e kemi sqaruar shumë qartë se tek Universiteti Haxhi Zeka ne jemi rekomanduar për kontratë, ku tanimë ka kaluar edhe afati për parashtrim të ankesave dhe jemi në pritje të nënshkrimit të kontratës, andaj referencat e prezantuara nga ne është dashur të merren parasysh, pasi që kontratat janë përfunduar ku ky fakt vërtetohet nga lëshimi i referencave.

Autoriteti kontraktues ka dhënë arsytetime të cilat nuk janë të qëndrueshme dhe të pa mbështetura në dispozita ligjore. Gjithashtu vendimi i autoritetit kontraktues është shumë i paqartë pasi që neve na ka aprovuar dy pretendime ankimore dhe më poshtë tek përfundimi i vendimit e cek se kontrata "Furnizim Me pelet për ngrohjen qendrore në UHZ" është marr parasysh, mirëpo më lart në vendim nuk e ka marr parasysh.

Ndërsa e njëjta ka devijuar nga gjendja reale e shumë se kontratave të përfunduara, ku e ka cekur se ne kemi prezantuar vlerë të referencave 1,180,866.86 euro, pa referencat me Universitetin Haxhi Zeka dhe pa referencën e lëshuar nga kompania Haxha Kom dhe pa referencën e lëshuar nga Komuna e Prizrenit në vlerën 30,940.00 euro. Ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm dhe ne nuk e dijmë

se çfarë përlllogaritje ka bërë autoriteti kontraktues, pasi që edhe pa kontratat që i ka cekur AK-ja ne e arrijmë vlerën 1,336,640.00, ndërsa kur llogariten edhe referencat e lëshuara nga Universiteti Haxhi Zeka dhe kompania Haxha Kom atëherë kuptohet qartë se ne e përmbushim dhe njëkohësisht e tejkalojmë vlerën e kërkuar në dosje të tenderit.

Sa i përket arsyetimit të AK-së në lidhje me referencën e prezantuar nga kompania Haxha Kom, ku e njëjta e ka cekur se nuk janë ofruar të gjitha transaksionet bankare, ju sqarojmë se AK-ja në lidhje me këtë çështje përveç faktit që nuk ka kërkuar sqarime shtesë në lidhje me transaksionet e njëjta një arsye të tillë nuk e kishte vendosur në njoftimin mbi vendimin e saj, mirëpo tani me qëllimin e vetëm që të na eliminoj neve nga aktiviteti i prokurimit, mundohet të vendos arsye tjera të cilat janë të paqëndrueshme.

Në lidhje me referencën e lëshuara nga ana e kompanisë Haxha Kom edhe pse referenca e tillë nuk është kontestuar dhe ne edhe pa këtë referencë e përmbushim kërkesën e dosjes së tenderit, me qëllim të korrektësisë, po ju bashkangjesim transaksionet bankare nga kompania Haxha Kom dhe njëkohësisht edhe librat e shitjes, ku vërtetohet fakti se kontrata me kompaninë Haxha Kom është përmbushur në tërësi.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i pa qëndrueshëm, njëkohësisht tendencioz kundrejt kompanisë tonë si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar fare dispozitat ligjore të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, pasi që nëse ka pasur ndonjë paqartësi në lidhje me referencat është dashur të kërkoj sqarime shtesë, mirëpo që një gjë të tillë nuk e ka bërë duke na diskriminuar neve si OE të përgjegjshëm.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse jemi eliminuar ne si OE i përgjegjshëm dhe njëkohësisht me çmim më të lirë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, sepse jemi eliminuar ne si i OE i përgjegjshëm, ndërsa është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik me çmim më të shtrenjtë se sa ne.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, duke u diskriminuar ne si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "*Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*".

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që "*Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse*", mirëpo AK-së nuk është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore, pasi që e ka rekomanduar për kontratë një OE i cili ka ofertuar me çmim më të shtrenjtë se sa ne edhe përkundër faktit që ne jemi OE i përgjegjshëm.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 6 i LPP-së, sepse autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, kur dihet që në këtë aktivitet të prokurimit ne jemi

Autoriteti kontraktues është dashur të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të

shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të lëshojë:

## VENDIM

**APROVOHET**, si e bazuar ankesa e OE N.T.P. " Gresa – Commerc" & MBB Contruction SH.P.K." si dhe të


**ANULOHET**, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) dhe lënda të kthehet në RIVLERËSIM dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

## KRITERET PËR VLERËSIM

<p><b>1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit 2. Certifikata e TVSH-s 3. Certifikata e numrit fiskal</b></p>	<p><b>1.Kopja e Certifikatës se biznesit, 2.Kopja e certifikates se TVSH-s, 3.Koja e Certifikatës se numrit fiskal</b></p>
<p><b>III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</b></p> <p><b>Kërkesa 1 - Operatori ekonomik duhet te ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i Operatorit Ekonomik, ne tre vitet e fundit fiskale, është jo më pak se 1,900,000.00 Euro.</b></p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p><b>Dëshmia 1 - Dokument nga banka për qarkullimin e OE ose pasqyrat e auditura financiare, ose deklaratat vjetore tatimore te dorëzuara ne ATK.</b></p>
<p><b>III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:</b></p> <p><b>Kërkesa 1 - Operatori Ekonomik duhet te ofrojë dëshmi se ka përfunduar projekte te ngjashme ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate së paku prej 1,400,000.00 Euro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit DHE dëshmi për përfundimin me suksese te këtyre projekteve.</b></p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p><b>Dëshmia 1 – Te dorëzoni listën në origjinal e vulosur dhe nënshkruar, të projekteve të ngjajshme të realizuara ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate, dhe dëshmitë e përfundimit Referencat ose procesverbalet e pranimit apo raportet përfundimtare për pranimin e furnizimeve të kryera.</b></p>
<p><b>Kërkesa 2 - Pajisjet e nevojshme me të cilat do të kryhen furnizimet. Minimumi i pajisjeve për këtë projekt është Tre (3) Kamion transportues.</b></p>	<p><b>Dëshmia 2 - Dëshmi mbi posedimin e paisje, nëse paisjet janë në pronësi të OE duhet të ofroj (Librezat valide kopje ose Dokumentin Unik Duganor, faturat e blerjes). Nëse OE ka Marrëveshje për Shfrytëzim të paisjeve OE duhet të ofroj Marrveshjen ( për Projekt) për shfrytëzim të paisjeve dhe dëshmin mbi paisjet e marrura me qerasi (kopjen e librezave valide ose Dokumentin Unik Doganor).</b></p>

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.T.P."GRESA - COMMERCE "", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me dru dhe pelet per ngrohje" me numër të prokurimit: "624-23-6986-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA SUHAREKË



**B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES<sup>1</sup>**

*Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzimit Operativ të Prokurimit Publik*

Titulli i kontratës: **Furnizim me dru dhe pelet per ngrohje**

Nr. I Prokurimit:	624-23-6986-1-1-1
Nr. I brendshëm:	624-23-50-111

**VLERESIMI FINANCIAR**

	Emri i tenderisit	Qmimi
1	N.P.T. " Burimi ", p.n. -, SOPI	899.100.00€
2	" WOOD COMPANY " SH.P.K., Lagjia Vitija, Marec, Prishtine. 10000, Prishtine	961.500.00 €
3	Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.P."GRESA - COMMERCE "; MBB Construction SH.P.K., Pirane. -, PIRANE	<u>885.150.00€</u>
4	Grup i Operatorëve Ekonomik Avni Murtezi B.I.; N.P.T. Meti Comerc ; Gëzime S. Gashi B.I., Jakup Ferri. -, PRISHTINË	957.060.00 €


Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

**Komuna e Suharekës – Zyra e Prokurimit shpërblen me kontratë N.P.T. " Burimi ", p.n. -, SOPI në vlerë totale të ofertës 899.100.00 €**

Data: 13.09.2023

Emri dhe mbiemri i ZPP: Fatos Kuqi

Nënshkrimi: Fatos Kuqi



B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar <sup>4</sup>

Suharekë: 13.09.2023

Zyra e prokurimit Komuna Suharekë, rr.Brigada 123 p.n Suharekë

Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.P."GRESA - COMMERCE "; MBB Construction SH.P.K,  
Pirane, - PIRANE

Nr. I Prokurimit:	624-23-6986-1-1-1
Nr. I brendshëm:	624-23-50-111

Titulli:Furnizim me dru dhe pelet per ngrohje

I/e nderuar Z. Sahit Bajrami

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Nuk e keni dorëzuar:

- Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;
- Nuk e keni plotësuar si duhet Formularin për dorëzimin e tenderit;
- Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;
- Nuk i keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara;
- Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant të prokurimit;
- Gabimi (et) aritmetikor i evidentuar(a) është më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës;
- Nëse është e zbatueshme, kërkesa tjera formale/administrative. [Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomik]
- Nuk keni paraqitur një deklaratë të qartë se të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe, në rast se grupit i është dhënë kontrata, performancën e kontratës;
- Nuk keni paraqitur deklaratën e nënshkruar nga secili anëtar, e cila konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër pjesëmarrës në procedurën e njëjtë të prokurimit;
- Nuk keni paraqitur deklaratën e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit e cila autorizon partnerin udhëheqës të veprimit në emër të grupit;
- Partneri juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë.

<sup>4</sup>Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtejshme ngase kanë qenë të pa përgjegjshëm dhe të parregullt (Shto letra njoftuese sipas nevojës).



Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.T.P."GRESA - COMMERCE "", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me dru dhe pelet per ngrohje" me numër të prokurimit: "624-23-6986-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA SUHAREKË

- Nuk jeni përgjegjës për kërkesën tonë për sqarimin e tenderit.
- Në rast të nënkontraktimit
- Nën-kontraktuesi (t) juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshatshmërisë. [Tenderi i juaj][Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:
- Certifikatat apo dëshmitë e kërkuara të cilat tregojnë apo pohojnë se nuk jeni i diskualifikuar nga ndonjë masë nën Nenin 65 të LPP;
- Certifikatën, dokumentin ose ndonjë dëshmi tjetër të mjaftueshme të kërkuar sipas Nenit 66 të LPP për të dëshmuar përshatshmërinë profesionale tuaj;
- Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 68 dhe 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të gjendjes ekonomike dhe financiare dhe të kapacitetit teknik/profesional të saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

### ARSYETIM

Tenderi i juaj është refuzuar ngase ju si Operator Ekonomik nuk keni ofruar referenca për furnizime në vlerën e kërkuar në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

Autoriteti kontraktues për kërkesën e parashtruar në DT sa i përket realizimit të kontratave ka kërkuar dëshmi në vlerë 1.400.000.00 ndërsa ju si Operator Ekonomik keni ofruar referenca për kontratat e realizuara në vlerë prej 827,753.37 Euro

Referencat në vijim nuk mund të pranohen nga AK ngase kontratat për të cilat keni ofruar referenca janë në realizim e sipër pra nuk janë të përfunduara.

Referenca – Shkola fillore Mesme e Ulet "8 Dëshmorët" në Kralan

Referenca – Furnizim me pelet për ngrohje të objekteve shkollore – Komuna Klinë

Referenca – Furnizim me pelet për ngrohje qendrore për fakultetin e biznesit MTHM-se – Kontrate Komiz – Universiteti Haxhi Zeka

Referenca – Furnizim me pelet për ngrohje qendrore në UHZ – Kontrate Komiz – Universiteti Haxhi Zeka

Ju informojmë se kontrata i është dhënë **N.P.T. " Burimi ", p.n. -, SOPI** në vlerë totale të ofertës **899.100.00 €**

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

Fatos Kuqi

Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit Nënshkrimi



INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

## VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

## ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

## PËRGGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - N.T.P."GRESA - COMMERCE "

Aktiviteti i prokurimit: "Furnizim me dru dhe pelet per ngrohje" me nr. të prokurimit: "624-23-6986-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA SUHAREKË, ka filluar me publikimin e njoftimit për kontratë me datë 08.07.2023, me procedurë të hapur, hapja e ofertave është bërë me datë 22.08.2023, si dhe vendimi mbi rekomandimin është publikuar me datë 13.09.2023.

OE ankuesi pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, me datë 02.10.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, duke pretenduar se OE i rekomanduar nuk i plotëson kriteret, si dhe AK nuk ka vlerësuar ofertat konform nenit 1, 6, 7, 59, 60, 61, 69, 72, të LPP-së si dhe neni 54.10 i Rregullores nr.01/2022 për Prokurim Publik.

OE ankuesi nga AK është shpallur i eliminuar me arsyetimin se nuk ka plotësuar kërkesat teknike profesionale, nuk ka ofruar referenca të mjaftueshme sipas kërkesës në DT 9.1&9.2.

Tutje, i njëjti sqaron se, sa i përket referencave të kontestuara nga AK lidhur me punët e kryera për projektet e potencuara nga AK në letrën standarde B42, deklaron se i ka përmbushur për faktin se projektet janë kryer para afatit duke e përmbushur kontratën 100% dhe ne disa 130% (+/-30% sasia indikativë).

**Ekspertja Shqyrtuese** pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, sa i përket pretendimit të parë dhe të tretë lidhur me referencat të cilat AK gjatë vlerësimit e eliminon si arsye, në kërkesën për rishqyrtim ia merr si të bazuara, si dhe kërkesa për rishqyrtim i aprovohet pjesërisht e bazuar.

Bazuar në të dhënat e lartë përmendura edhe pse dy pretendimet ankimore janë pruanr si të bazuara referencat për Kontratat me tituj "Shkolla fillore e Mesme e Ulët "8 Dëshmorët" në Kralan", "FURNIZIM ME PELET PËR NGROHJEN QENDRORE NE UHZ-ë-KONTRATË KORNIZË" Autoriteti Kontraktues qëndron pran njoftimit mbi vendim (B58) të publikuar me datë 13.09.2023 ngase:

Autoriteti kontraktues për kërkesën e parashtruar në DT sa i përket realizimit të kontratave ka kërkuar dëshmi (referenca) në vlerë 1.400.000.00 ndërsa ju si Operator Ekonomik (edhe pas pranimit të dy referencave të lartë përmendura) nuk keni ofruar referenca në vlerën e kërkuar nga AK. Vlera e referencave të ofruar nga ju si OE është 1,180,866.86 Euro kështu që AK do të qëndron pran njoftimit mbi vendim (B58) të publikuar me datë 13.09.2023 ngase, rezultati nuk ndryshon edhe pas pranimit të dy referencave të lartë përmendura.

Tutje, pretendimit të dytë:

2. Sa i përket referencës tjetër të cilën AK-ja nuk e ka marr parasysh- Furnizim me pelet për ngrohje të objekteve shkollore-Komuna Klinë, ju sqarojmë se edhe në këtë rast kontrata për të cilën është lëshuar kjo referencë është e përfunduar 128%, pra përveç se është kryer furnizimi i 100% të kontratës, AK-ja KK Klinë ka shfrytëzuar edhe 28% e devijimit të lejuar.

Përveç këtij fakti, AK-KK Klinë ka publikuar aktivitetin e prokurimit të njëjtë sikurse aktiviteti për të cilin ne i kemi bërë furnizimet dhe njëkohësisht ka nënshkruar edhe kontratën për të njëjtin aktivitet, pra është nënshkruar një kontratë e re.

Me kërkesë për rishqyrtim e kemi bashkangjitur edhe sqarimin e KK Klinë, ku të njëjtit e konfirmojnë faktin se e kanë kaluar kontratën me 128% dhe se të njëjtit kanë lidhur një kontratë të re.

Andaj nga kjo dëshmi kuptohet se edhe kjo kontratë ka përfunduar për faktin se tanimë KK Klinë ka lidhur një kontratë të re me një OE tjetër dhe kjo kontratë është e përfunduar, andaj edhe referenca është dashur të merret parasysh. (Bashkangjitur gjeni sqarimin dhe konfirmimin nga KK Klinë dhe kontratën e nënshkruar).

**Ekspertja Shqyrtuese** lidhur me pretendimin e dytë sqaron se, kontrata e cila skadon me datë 28.11.2023, AK -Komuna Klinë, AK ka iniciuar aktivitet të prokurimit para kohe me qëllim që të sigurohet me kontratë, për arsye se sasia e parashikuar është shpenzuar para përfundimit të kontratës, dhe në E-prokurim shohim kontratën e re për aktivitetin e njëjtë nga i njëjti autoritet, siç edhe pretendon OE ankuesi, pra kontrata në listë i bie se është e përfunduar, po ashtu edhe në referencë është e specifikuar se thuhet edhe sasia + 30% gati është shpenzuar, dhe si e tillë AK -Klinë ka vazhduar me aktivitet të ri të prokurimit, andaj nga sqarimet më lartë konsideroj se kjo referencë duhet të merret e mirëqenë, **pretendimi i OE ankuesit gjendet i bazuar.**

## REFERENCË

Me të cilën dëshmojmë se OE "GRESA-COMERC" N.T.P., emri i biznesit Sahit Bajrami B.I., me seli në Piranë, me nr.biznesi 810584327, ka kryer punët sipas kontratës "Furnizim me pelet për ngrohje të objekteve shkollore". Punët e furnizimeve i ka kryer në nivelin më të lartë dhe ka respektuar procedurat administrative. OE "GRESA-COMERC" N.T.P.ka respektuar në tërësi sigurimin e cilësisë së punëve sipas përshkrimit të kontratës me nr.90-2022 e datës 30.11.2022 me nr.prokurimit 634-22-10007-1-2-1, kontratë njëvjeçare, vlera e kontratës është 103,350.50€, me mundësi furnizimi +30%.

Drejtoria Komunale e Arsimit në Klinë është e kënaqur me korrektësinë dhe përgjegjësinë e kësaj kompanie, sepse të gjitha kontaktet dhe niveli i komunikimit me këtë kompani kanë qenë në nivelin më të lartë të mundshëm. Realizimi i kontratës ka arritur shumën 130,891.49 euro.

Me respekt

12	FURNIZIM ME PELET PER NGROHJE TE OBJEKTEVE SHKOLLORE	KOMUNA KLINE	634-22- 10007-1-2-1	30.11.2022	28.11.2023	<u>130891,49</u>
----	--	-----------------	------------------------	------------	------------	------------------

### Pretendimi i katërt i OE ankuesit:

Sa i përket arsyetimit të AK-së në lidhje me referencën e prezantuar nga kompania Haxha Kom, ku e njëjta e ka cekur se nuk janë ofruar të gjitha transaksionet bankare, ju sqarojmë se AK-ja në lidhje me këtë çështje përveç faktit që nuk ka kërkuar sqarime shtesë në lidhje me transaksionet e njëjta një arsye të tillë nuk e kishte vendosur në njoftimin mbi vendimin e saj, mirëpo tani me qëllimin e vetëm që të na eliminoj neve nga aktiviteti i prokurimit, mundohet të vendos arsye tjera të cilat janë të paqëndrueshme.

Në lidhje me referencën e lëshuara nga ana e kompanisë Haxha Kom edhe pse referenca e tillë nuk është kontestuar dhe ne edhe pa këtë referencë e përmbushim kërkesën e dosjes së tenderit, me qëllim të korrektësisë, po ju bashkangjesim transaksionet bankare nga kompania Haxha Kom dhe njëkohësisht edhe librat e shitjes, ku vërtetohet fakti se kontrata me kompaninë Haxha Kom është përmbushur në tërësi.

**Ekspertja shqyrtuese** lidhur me pretendimin sqaron se, ky pretendim nuk ka qenë i parashtruar në kërkesën për rishqyrtim, për faktin se kjo kontratë nga kompania Haxha Kom fillimisht është marrë si e mirëqenë sepse në ofertë i njëjti ka të bashkangjitura disa

transaksione bankare, librat e evidentimit, dhe si e tillë, meqenëse AK konsideron se nuk ka dëshmi të mjaftueshme, atëherë gjatë procesit të rivlerësimit mund të kërkoj sqarime, konform nenit 72 të LPP-së, duke marrë për bazë po ashtu edhe udhëzuesin nr.001/2023 për Prokurim Publik:

**iii. Shënim për kërkesat e aftësisë teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-se):**

- Në përputhje me ligjin e prokurimit publik, AK mund të kërkoj nga OE një listë të projekteve të realizuara në 3 vitet e fundit. Kësaj liste duhet t'i bashkëngjiten si dëshmi:
  1. Kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata /raport pranimi/ reference) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë. të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar.
  2. Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë;
- Në të gjitha rastet e përfshira në 2.1, 4.2 dhe 6.2 të nenit 69 të LPP-se përmendet shprehja si në vijim citojmë: "të realizuara (përfunduar) në tri vitet e shkuara "ose" në periudhën e shkuar trevjeçare..."). Në kuptimin e Ligjit shprehja "tri vitet e shkuara" nënkupton: "periudhën kohore të përcaktuar në këto nene e cila ndërlidhet me periudhën që paraprinë datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin e ftesës për pjesëmarrje ose tenderim.

**UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK**

- Në këto situata rekomandohet që data nga e cila fillon të kalkulohet periudha e shkuar tre vjeçare të vendoset data e publikimit të Njoftimit për kontratë, përkatësisht e dërgimit të ftesës për pjesëmarrje.

**Këshillë:** Shumë AK i aplikojnë kërkesat e nenit 68 dhe/ose 69 të LPP-së edhe për rastet kur nuk kanë ndonjë rëndësi apo nevojë për tu dëshmuar (p.sh. për aktivitetet të cilat kanë për qëllim furnizimin me mallra e të cilat nuk prodhohen nga ofruesi i tyre). Në këto aktivitete aplikimi i kriterëve nga neni 68 dhe/ose 69 të LPP nuk është i arsyeshëm përkundrazi është jo profesional dhe mund të shkaktoj probleme të panevojshme.

Nga kalkulimet e AK-së vlera 1,180,866.86 nëse i shtohen edhe referencat e Haxha Kom si dhe Komuna e Klinës, atëherë OE ankuesi e tejkalon vlerën 1,400,000.00 euro.

2	KONTRATE PUBLIKE KORNIZË – FURNIZIM ME LENDE DJEGESE - DRU	NTP HAXHA – HAXHI ZENULLAHU B.I.	03/2019	10.09.2019	10.09.2022	210900
---	---	---	---------	------------	------------	--------

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.T.P."GRESA - COMMERCE "", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me dru dhe pelet per ngrohje" me numër të prokurimit: "624-23-6986-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA SUHAREKË

12	FURNIZIM ME PELET PER NGROHJE TE OBJEKTEVE SHKOLLORE	KOMUNA KLINE	634-22- 10007-1-2-1	30.11.2022	28.11.2023	130891,49
----	--	-----------------	------------------------	------------	------------	-----------

Andaj si e tillë, meqenëse OE ankuesi ka ofertuar me çmimin më të ulët, po ashtu edhe kriteri është çmimi më i ulët, atëherë konstatoj se AK duhet që aktivitetin e prokurimit ta rivlerësoj konform dispozitave ligjore të LPP-së, udhëzuesit nr 001/2023 për PP si dhe Rregullorja nr 001/2022 të PP, për faktin se OE ankuesi pas këtyre sqarimeve në rivlerësim duhet të ishte i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

#### REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.T.P."GRESA - COMMERCE "", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me dru dhe pelet per ngrohje" me numër të prokurimit: "624-23-6986-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA SUHAREKË

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA SUHAREKË**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **N.T.P."GRESA - COMMERCE "**

**Blerina Huruglica**

